

VENDIM
Nr. 133, datë 13.9.2012

PËR ANËTARËSIMIN E ERE-S NË UNIONIN NDËRKOMBËTAR TË GAZIT (IGU)

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 germa “gj” të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 13.9.2012, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur nga Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë mbi mundësinë e anëtarësimit të ERE-s në Unionin Ndërkombëtar të Gazit (IGU),

VENDOSI:

1. Anëtarësimin e ERE-s në Unionin Ndërkombëtar të Gazit (IGU).
 2. Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Administratë-Financës dhe Marrëdhënieve me Jashtë, të vijojë procedurat për anëtarësimin e ERE-s në këtë organizatë.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani